

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Krimeve të Rënda- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Mejreme Memaj e Hava Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarve Enver Hasani, nga Prishtina, rruga “Rrustem Statovci”, Hakif Veliu, me vendbanim ne fshatin Uglar, rruga Abdurrahman shala, komuna e Graçanicës, dhe Albert Rakipi, nga Tirana, rruga “Emin Duraku”, nr.10/a, Republika e Shqipërisë, për veprën penale mashtrimi në detyrë, parashikuar me nenin 341 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurores të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të akuzuarit Enver Hasani dhe mbrojtësit të tij avokatit Bajram Tmava dhe mbrojtësve të të akuzuarve Hakif Veliu e Albert Rakipi avokatëve Skënder Musa e Gazmend Nushi dhe përgjigjes në ankesën e Prokurorit nga mbrojtësi i të akuzuarit Enver Hasani, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.432/2015 datë 18 tetor 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 2 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit Enver Hasani dhe mbrojtësit të tij aktgjykimi i Gjykatës i Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.432/2015 datë 18 tetor 2017 përkitazi me këtë të akuzuar ndryshohet ashtu që Gjykata e Apelit këtë të akuzuar konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP e liron nga akuza se:

“ Si person zyrtar – Rektor i Universitetit të Prishtinës (UP) ne bashkëkryerje me Hakif Veliu person zyrtar– Shef i Prokurimit ne UP dhe Albert Rakipi person zyrtar – Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtarë (ISN) nga Tirana me qëllim të përfutimit të kundërligjshmen të dobisë pasurore për kompaninë ISN sipas marrëveshjes paraprake kanë falsifikuar kontratën origjinale “Përktimi i librave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe për nevojat e Universitetit të Prishtinës”, me ref.nr.43/08 datë 5.12.2008 e cila kontratë në nenin 17 përcakton vlerën totale të kontratës në shumë prej 500.000.00€ dhe çmimin e pagesës 12.65€ për 1000 fjalë, ashtu që me 8 dhjetor 2008 zv. Drejtori i kompanisë ISN Jorgji Qirijako i ka dërguar të akuzuarit Enver Hasani kërkesë për ndryshimin e kontratës nga njësia matëse “fjala” në njësinë matëse “karakterë” ku pastaj i akuzuari Hakif Veliu sipas marrëveshjes me të akuzuarin Enver Hasani ka përpiluar një kontratë të re ne të cilën ka ndryshuar nenin 17 të kontratës origjinale, ashtu që në vend të çmimit 12.65€ për 1000 fjalë ka shënuar çmimin 12.65€ për 1000 karaktere, duke i mundësuar ne këtë mënyrë ISN-së përfitim me të madh për sasinë e njëjtë të shërbimit dhe për të sjellë në lajthitje personat e autorizuar të UP-së për kryerjen e pagesës së kundërligjshme, i

akuzuari Hakif Velu ne kontratën e falsifikuar ka mbajtur numrin dhe datën e kontratës origjinale, të cilën kontratë i akuzuari Enver Hasani me 13 dhjetor 2008 e ka dërguar në Tiranë për ta nënshkruar i akuzuari Albert Rakipi, i cili pastaj ne bazë të kontratës së falsifikuar me datën 13 korrik 2009 ka dërguar ne UP faturën për përkthimin e tetë librave me çmim prej 78.999.25€ e llogaritur sipas njësisë matëse “karaktere” që sipas kontratës origjinale e llogaritur sipas njësisë matëse “fjala” kishte kushtuar 14.991.91€, si dhe faturën për përkthimin e dokumenteve të akreditimit te UP-së me çmim prej 8.542.55€, e llogaritur sipas njësisë matëse “karaktere” që sipas kontratës origjinale e llogaritur sipas njësisë matëse “fjala” kishte kushtuar 106.083€ dhe për të sjellë ne lajthitje personat e autorizuar te UP-së për kryerjen e pagesës së kundërligjshme i akuzuari Albert Rakipi ne ato fatura ka shënuar shenjen 1000/F gjë që tek anëtarët e komisionit të UP-së për pranimin e materialit të përkthyer ka krijuar lajthitje se llogaritja e përkthimit është bërë me njësinë matëse “fjala” kështu që ky komision duke aprovuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kryera nga ISN ka rekomanduar ekzekutimin e pagesës ndërsa i akuzuari Hakif Velu edhe pse e dinte se ISN ka llogaritur çmimin e përkthimit sipas njësisë matëse “karaktere” me datën 7 shtator 2009 ka lëshuar urdhër blerje për pagesë në shumë prej 87.541.80€, ndërsa me datën 17 shtator 2009 Shërbimi i Financave të UP-së këto para ia transferon ISN-së, ne të cilën mënyre të akuzuarit i siguruan kompanisë ISN përfitim të kundërligjshëm financiar në shumë prej 70.131.27€ ne dëm të UP-së.

-Me çka si bashkekzekutor kishte për të kryer veprën penale mashtrimi në detyrë, parashikuar me nenin 341 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK

Për shkak se nuk është provuar se e ka kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale përkitazi me këtë të akuzuar i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

II. Me aprovimin e ankesës së Prokurores aktgjykimi i lartcekur ndryshohet sa i përket vendimit për dënim përkitazi me të akuzuarit Hakif Velu dhe Albert Rakipi, ashtu që kjo Gjykatë këta të akuzuar për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor i gjykon secilin me nga 1(një) vit burgim.

III. Me aprovimin e pjesëshëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve Hakif Velu dhe Albert Rakipi aktgjykimi i shkallës së parë ndryshohet pjesërisht edhe sa i përket kërkesës pasurore juridike (vetëm sa i përket detyrimit të pandehurve për ta kompensuar dëmin e shkaktuar), ashtu që e dëmtuara – Universiteti i Prishtinës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Hakif Velu dhe Albert Rakip në pjesët tjera refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.432/2015 datë 18 tetor 2017 të akuzuarit Enver Hasani, Hakif Velu e Albert

Rakipi i ka shpall fajtor për shkak se si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale mashtrimi në detyrë, parashikuar me nenin 341 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK. Për këtë veprë penale të akuzuarin Enver Hasani e ka gjykuar me kusht, ashtu që ia ka caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një(1) viti, dhe ka urdhëruar që ky dënim mos të ekzekutohet me kusht që i akuzuari në afat prej dy (2) viteve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të mos kryej veprë penale, kurse të akuzuarit Hakif Veliu e Albert Rakipi secilin veç e veç i ka gjykuar me nga gjashtë (6) muaj burgim, te cilat dënime konform dispozitës së nenit 47 të KPRK ua ka zëvendësuar me dënime me gjobë në shumë prej nga 10.000 (dhjetëmijë)€ të cilat janë obliguar që t'i paguajnë në afat prej 60 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se të akuzuarit nuk do ta paguajnë dënimin me gjobë do te mbetet në fuqi dënimi me burgim. Të akuzuarit janë obliguar që të dëmtuarës Universiteti i Prishtinës t'ia kompensojnë në mënyrë solidare shumën prej 70.131.27 në afat prej 90 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Kontrata me numër ref.nr.43/8 datë 5.12.2008 e cila parasheh çmimin prej 1000 "karakterë" 12.65€ është anuluar. Janë obliguar që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor secili nga 200€.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesa të afatshme:

-Prokurorja e Prokurorisë Speciale vetëm për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime me të larta burgimi,

-i akuzuari Enver Hasani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit për dënimin dhe kërkesës pasurore juridike, me propozim që ankesa të aprovohet kurse aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ai të lirohet nga akuza,

-mbrojtësi i të akuzuarit Enver Hasani avokati Bajram Tmava për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza. Ka kërkuar që se bashku me të mbrojturin e tij të njoftohet për seancën e kolegjit,

- mbrojtësit e të akuzuarit Hakif Veliu avokati Skënder Musa, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu i akuzuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim,

- mbrojtësit e të akuzuarit Albert Rakipi, avokati Gazmend Nushi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit për dënimin shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesës pasurore juridike, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu i akuzuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim,

-mbrojtësi i të akuzuarit Enver Hasani është përgjigjur në ankesën e Prokurores me propozim që ajo të refuzohet si e pabazuar.

Kolegji i kësaj Gjykate e shqyrtoj propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit Enver Hasani për pjesëmarrje në seancë, mirëpo, meqë njoftimi për seancën e kolegjit palëve konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP ju dërgohet vetëm kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, dhe në rastin konkret i akuzuari Enver Hasani është gjykuar me kusht, kurse te akuzuarve tjerë dënimi me burgim u është zëvendësuar me gjobë, kjo Gjykatë nuk e konsideroj të arsyeshëm pjesëmarrjen e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre në seancën e kolegjit. Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.34/2018 datë 23.01.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurores të aprovohet, kurse ankesa e të akuzuarit Enver Hasani, mbrojtësit të tij dhe ato të mbrojtësve të të akuzuarve Hakif Veliu e Albert Rakipi te refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, i vlerësoi pretendimet ankimore dhe konstatoi:

Ankesa e të akuzuarit Enver Hasani dhe mbrojtësit të tij është e bazuar, kurse ajo e Prokurorit për dënimin përkitazi me të akuzuarit Hakif Veliu dhe Albert Rakipi është e bazuara, ankesat e mbrojtësve të të këtyre të akuzuarve sa i përket kërkesës pasurore juridike janë të bazuara kurse ne pjesët tjera nuk janë të bazuara.

1. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Pa marrë parasysh se në ankesën e të akuzuarit Enver Hasani, atë të mbrojtësit të tij dhe mbrojtësit të të akuzuarit Hakif Veliu pretendimet ankimore përkitazi me bazën ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale janë ngushtë të ndërlidhura me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljen e ligjit penal, Gjykata e Apelit do të jap vlerësime më poshtë veç e veç për çdonjërin bazë.

Edhe pse me ankesë Prokurorja aktgjykimin e shkallës së parë e kundërshton vetëm sa i përket vendimit për dënimi nga arsyetimi del se ajo aktgjykimin e kundërshton edhe për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në fakt Prokurorja ne këtë drejtim nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur, por thekson se kjo shkelje ka të bëjë me refuzimin e gjykatës së shkallës së parë për administrimin e provave – korrespondencës elektronike të dorëzuar nga i akuzuari Albert Rakipi i cili si në procedurën para parake ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar se kontrata e re është hartuar në marrëveshje të plotë me menaxhmentin e UP respektivisht të akuzuarin Enver Hasani dhe Hakif Veliu. Origjinën dhe përmbajtjen e kësaj korrespondence nuk e kontestojnë të akuzuarit Hakif Veliu e Albert Rakipi e as dëshmitari Jorgji Qirijako. Mirëpo, gjykata jashtë seancës merr vendim që kjo korrespondencë të mos administrohet si provë në shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se këto prova janë thellësisht të pa mbështetshme ngase origjina e provës apo informatës është e panjohur dhe bazuar në faktin se nuk ka ekzistuar urdhëresa përkatëse apo ndonjë ekspertizë e pajisjeve elektronike. Sipas Prokurores një vendim i tillë është në

kundërshtim me aktvendimin e Gjykatës PKR.nr.432/2015 datë 11 janar 2016 gjatë fazës së kundërshtimit të akuzës me të cilin është konfirmuar pranueshmëria e kësaj korrespondencë si provë, e i cili vendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Provat - korrespondenca elektronike e dorëzuar nga i akuzuari Albert Rakipi janë të pranueshme edhe sipas Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës datë 12 janar 2015, ndërsa mos administrimi i tyre në shqyrtimin gjyqësor sipas Prokurores ka ndikuar në gjendjen faktike.

I akuzuari Enver Hasani dhe mbrojtësi i tij edhe pse e kundërshtojnë aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me këtë bazë ankimore në fakt pretendimet në këtë drejtim i referohen gjendjes së fakteve ngase kontestohen konkludimet e gjykatës në bazë të provave të administruara (pretendohet se këto prova nuk argumentojnë veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit).

Mbrojtësi i të akuzuarit Hakif Veliu pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.7, 11.8 dhe 1.12 të KPP për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërshtim të plotë me arsyetimin. Po ashtu sipas këtij mbrojtësi aktgjykimi mbështetet edhe në provë të papranueshme konkretisht kontratën në mes të UP dhe ISN me nr.ref. 43/2008 datë 5.12.2008 dhe kontratën e datë 8.12.2008 e nënshkruar nga zëvendës-drejtori i kompanisë ISN dhe i mbrojturi i tij me të cilën kontratë sipas prapavijës së zt. Qirjaku është ndërruar njësisia matëse dhe atë nga njësisia matëse fjalë në njësinë matëse karakter, mirëpo gjykata në këtë rast fare nuk e ka marrë parasysh faktin se këto ndryshime janë bërë vetëm si referencë për ISN dhe nuk kanë prodhuar efekte juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit Albert Rakipi pretendon se me aktgjykimin e kundërshtuar gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar akuzën e paraqitur nga Prokuroria dhe që pasqyrohet në vendimin e gjykatës së shkallës së parë për anulimin e kontratës me ref.nr.43/2008 datë 5.12.2008 e cila parasheh çmimin prej 1000 karaktere 12.65€. Sipas nenit 458.2 të KPRK kërkesa pasurore juridike përpos në formën e kërkesës për kompensimin e dëmit dhe kthimin e sendit mund të parashtrohet edhe në formën e kërkesës për anulimin e një veprimi konkret juridik. Kurse sipas dispozitës së nenit 459 të KPPK kërkesën pasurore juridike mund ta parashtrojnë personi i cili është i autorizuar që ta ushtron kërkesën për anulim në procedurën civile dhe në rastet kur është dëmtuar pasuria në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore, organi ose personi kompetent i cili është autorizuar me ligj të kujdeset për mbrojtjen e kësaj pasurie. Sipas mbrojtësit as në aktakuzën e Prokurorisë dhe deklarimin e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar sikurse edhe gjatë tërë procedurës së zhvilluar para Gjykatës së shkallës së parë asnjëherë nga personat përgjegjës dhe të autorizuar konform dispozitës së nenit 459 të KPPK nuk është paraqitur kërkesë pasurore juridike në formën e kërkesës për anulim të veprimit konkret juridik. Ndërsa, vendosja përkitazi me një kërkesë inekzistente pasurore juridike paraqet tejkalim të akuzës që sanksionohet sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesa dhe as që ka shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzohin anulimin e tij. Se pari vlen të theksohet se refuzimi i një propozimi konkret të palëve qofte për

administrimin e një prove apo ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural nuk ka të bëjë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale aq me tepër kur gjykata jo vetëm me vendim të veçantë ka dhënë arsye se perse ka refuzuar që të administroj si provë materiale korrespondencën elektronike të dorëzuar nga i akuzuari Albert Rakipi por edhe në arsyetimin e të aktgjykimit ka dhënë arsye në këtë drejtim. Se, dyti nuk rezultoi se ky vendim i gjykatës është në kundërshtim me vendimin e marrë gjatë kundërshtimit të provave, sepse siç del nga shkresat e lëndës respektivisht aktakuzat e ngritura Prokurorja përkundër që e ka mbështetur aktakuzën në këtë provë të dorëzuar nga i akuzuari Albert Rakipi ajo nuk ka propozuar që kjo provë të administrohet në shqyrtimin gjyqësor, madje as propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit Albert Rakipi që kjo provë të lexohet në shqyrtimin gjyqësor fillimisht nuk e ka përkrahur, ndërsa a ka vepruar drejt gjykata në këtë drejtim do të behet fjalë në kuadër të gjendjes faktike. Ndërsa, pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit Hakif Veliu se aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet në provë të papranueshme dhe ato të mbrojtësit të të akuzuarit Albert Rakipi se me aktgjykimin e kundërshtuar është tejkualuar akuzat jo vetëm që janë të pabazuara por edhe të paqarta. Sepse, me dispozita ligjore – nenin 257 të KPP është përcaktuar se kur një provë konsiderohet e papranueshme dhe sipas kësaj dispozite provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme, kurse, siç del nga shkresat e lëndës provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje janë marrë konfirmim dispozitave ligjore, ndërsa, sa këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata. Nga fakti se gjykata pa kërkesën e personit të autorizuar ka vendosur përkritazi me kërkesën pasurore juridike nuk mund të konkludohet se gjykata me aktgjykimin e kundërshtuar ka tejkualuar akuzën. Ngase, tejkualimi i aktakuzës në kuptimin objektiv nënkupton tejkualimin e aktakuzës kur me aktgjykim përfshihet edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës. Kurse, tejkualimi i aktakuzës në kuptimin subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar. Ndërsa, a ka vepruar drejt gjykata e shkallës së parë sa i përket kërkesës pasurore juridike kjo Gjykatë do të jep vlerësime në vijim. Ndërkaq, konkludimet e Gjykatës përkritazi me përgjegjësinë penale të të akuzuarit Enver Hasani në raport me gjendjen faktike të vërtetuar sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë të gabuara, konkludime këto që i përkasin edhe zbatimit të ligjit penal për çka edhe në këtë drejtim do të behet fjalë në kuadër të gjendjes faktike.

a) Pretendimet ankimore përkritazi me gjendjen faktike dhe zbatimin e ligjit penal.

Përkritazi me këtë bazë ankimore i akuzuari Enver Hasani dhe mbrojtësi i tij i kontestojnë konkludimet e gjykatës në bazë të provave të administruara. Kështu, sipas mbrojtësit të të akuzuarit gjykata e shkallës së parë konkludimin e saj përkritazi me përgjegjësinë penale të të akuzuarit Enver Hasani e mbështet në dëshminë e dëshmitarit Jorgji Qirijako dhe Marian Dema. Dëshmitari Jorgji Qirijako në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me kontratën kontestuese ka theksuar në kontratë kanë vërejtur se çmimi për përkthim ishte llogaritur në “fjalë” dhe e ka ditur se është dashtë të jetë me “karakterë”. Me 8.12.2008 i kishte shkruar email Enver Hasanit dhe ia kishte paraqitur vërejtjet. Pas paraqitjes së vërejtjeve veçanërisht lidhur me nenin 17 Hakifi i kishte thënë se pas përmirësimit të nenit 17 kontratën ta dërgoj përmes shoferit. Me 13.12.2008 në Tiranë kishte takuar dy drejtues të UP - Enver

Hasanin dhe Marjan Dema – ketë të fundit nuk e kishte njohur dhe meqë e ngiste makinën kishte menduar se ishte shoferi. Mariani ia kishte dhënë zarfin e Hakifit dhe kishte shkuar në zyrë ku Drejtori e kishte nënshkruar kontratën. Dy kopje të kontratës i kishte mbajtur dhe dy i kishte lenë në zarf dhe ia kishte dhënë Marianit. Nga Rektori i Universitetit nuk kishte marrë përgjigje për shqetësimet e tyre rreth kontratës. Mirëpo, sipas mbrojtësit dëshmia e këtij dëshmitari demantohet nga shkresa e Rektorit Dhori Kole sipas të cilit në seminarin 12,13 e 14 dhjetor 2008 do të mbahej takimi i Rektorëve të Universitetit shqipfolës, takim ky i cili ishte mbajtur. **Kurse, dëshmia e dëshmitarit Marian Dema e dhënë në shqyrtimin gjyqësor është kundërthënëse me dëshminë e tij të dhënë në prokurori , dhe nga dëshmia e tij e dhënë në shqyrtimin gjyqësor del qartë se qëllimi i tij ishte që në një mënyrë apo ndonjë mënyrë tjetër ta inkriminojë të akuzuarin Enver Hasani.** Mirëpo, pavarësisht kësaj ky dëshmitar rrethanën kryesore “pretendimin e prokurorisë së Enver Hasani kontratën e përmirësuar e ka dërguar në Tiranë” e ka mohuar kategorikisht.

Mbrojtësi i të akuzuarit Hakif Veliu pretendon se në bazë të provave të administruara del qartë se i akuzuari nuk ka qenë personi zyrtar- përgjegjës i vetëm për realizimin e kontratës për shkak se për tu bërë pagesa është dashur që të realizohen edhe një serë veprimesh tjera nga zyrtari i pranimit, zyrtari shpenzues, zyrtari kryesor i autorizuar ZKA dhe zyrtari certifikues. Bazuar në këtë hierarki të këtij sistemi të ekzekutimit të pagesave zyrtari i prokurimit është i dyti, kurse lënda duhet të kalojë edhe katër filtra tjerë që pagesa të ekzekutohet. Ndërsa, asnjë veprim i të akuzuarit nuk është ndërmarrë jashtë këtyre rregullave, pra ai ka vepruar në pajtim me udhëzuesin operativ të prokurimit publik sipas të cilit (neni 10) përgjegjës për pranimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në sasi dhe sipas kontratës i bartë komisioni i pranimit. Kjo nënkupton se komisioni ka qenë përgjegjës që tekstet dhe materialet e pranuar t’i kontrollojë në sasi dhe në cilësi për të vërtetuar se fatura e prezantuar nga operatori ekonomik është në pajtueshmëri me sasinë, kurse gjykata e ngarkon vetëm të akuzuarin Hakif kurse komisionin nuk e ngarkon me asnjë obligim ligjor. Gjykata nuk e ka marrë parasysh faktin se i akuzuari ketë aktivitet të prokurimit e ka gjetur në proces të vlerësimit në kohën e marrjes së detyrës pasi që termat e referencave apo njësive matëse i kanë caktuar zyrtarët tjerë gjatë procedurës së inicimit. Pas fillimit të punës i akuzuari ka vazhduar me vlerësimin e ofertave sipas ligjit të prokurimit deri në nënshkrimin e kontratës, kurse pretendimet e ISN se është dashur të rritet çmimi në bazë të njësisë matëse “karakteret” asnjëherë nuk janë pranuar nga akuzuari prandaj pa të drejtë konkludohet se ai e ka kryer veprën penale mashtrimi në detyrë. Përveç kësaj, gjykata ka vlerësuar njëanshëm ekspertizën financiare duke ju referuar vetëm kontingjentit të parë të përkthimeve, mirëpo nuk ka marrë për bazë kontingjentin e dytë të librave të cilat nuk janë paguar. Ngase, sipas ekspertizës shuma e përgjithshme e përkthimeve sipas njësisë matëse “fjala” është 70.965.10€, kurse Universiteti i Prishtinës ka paguar 86.465.13€ e që sipas ekspertizës ndryshimi është 16.576.53€ pra, dëmi i shkaktuar.

Kurse, mbrojtësi i të akuzuarit Albert Rakipi pretendon se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të akuzohet (mashtrimi në detyrë) ngase në kohën kur pretendohet kryerja e veprës penale i akuzuari nuk e kishte statusin e personit zyrtar. I akuzuari është shtetas i Republikës së Shqipërisë-Drejtor i Institutit për Studime ndërkombëtare (ISN) dhe ky institut është i regjistruar si etnitet juridik vetëm në Republikën e Shqipërisë ku edhe ushtron aktivitetin e saj, dhe asnjëherë nuk ka pasur dhe nuk e ka të themeluar ndonjë degë/etnitet juridik të

vetin ne territorin e Republikës së Kosovës, kurse qëndrimi i gjykatës ne ketë drejtim është i pambështetur. Po ashtu nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorisë se është falsifikuar kontrata ref.nr.43/8 datë 5.12.2008 dhe një fakt i tillë nuk argumentohet as nga ekspertiza grafologjike, kurse po të mos ishte i akuzuari as Prokuroria as gjykata dhe as pala e dëmtuar nuk do ta kishin ne disponim ketë kontratë. Meqë komisioni “ad hoc”- kishte mandat te shqyrtoj cilësinë e përkthimeve te librave nga gjuha angleze ne atë shqipe dhe se komisioni nuk ka pasur lidhje me mënyrën e pagesës nuk është vërtetuar se i akuzuari me vendosjen e shenjës 1000/F ne faturë i ka venë në lajthim anëtarët e komisionit. Pastaj gjykata ka konstatuar se dëmi i shkaktuar Universitetit të Prishtinës është 70.131.27€ , por ky konkludim është ne kundërshtim me ekspertizën financiare. Me tej, konkludimi i gjykatës se të pandehurit Albert Rakipi dhe Hakif Veliu me qëllim të përfitimit te dobisë se kundërligjshme për vete dhe personin tjetër kishin planifikuar dhe me pas ndryshuar kontratën e datës 5.12.2008 është i gabuar ngase për të vërtetuar një fakt të tillë gjykata do të duhej të kishte prova për njohjen ne mes tyre, takimet dhe komunikimet ne mes tyre dhe nga shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë ne ketë drejtim. Pastaj, provat materiale si vendimi i Këshillit drejtues te UP ref,nr.4/488 datë 28.12.2007 që përcakton “karakterin” si njësi matëse ne përkthimin e librave, dosja e tenderit te UP dhe rezultati i super ekspertizës që tregon çmimin aktual te rezultateve te përkthimit te teksteve universitare dëshmojnë se qëllimi nuk ka qenë përfitimi i dobisë se kundërligjshme por pamundësia e zbatimit të kontratës se parë me njësi matëse “fjalë”. Mos vërtetimi i drejtë i gjendjes faktike rezulton edhe si pasojë e refuzimit të gjykatës për të administruara si provë materiale komunikimet elektronike mes Jorgji Qirjako -zëvendës drejtorit te ISN dhe të akuzuarit Hakif Veliu ngase i terë komunikimi rreth ndryshimit të neneve te kontratës është zhvilluar mes Jorgji Qirjakos dhe Hakif Veliut, kurse i akuzuari Albert asnjëherë nuk ka qenë i kyçur ne mënyrë të drejtpërdrejtë ne ketë komunikim. Ndërsa, si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të gjithë mbrojtësit pretendojnë se është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarve.

Kështu, sipas shkresave të lëndës respektivisht provave të administruara del se:

Universiteti i Prishtinës (UP) si autoritet kontraktues kishte bërë ftesë për tender (kontratë) me nr.90400/08/043/211 datë 8.07.2008 për shërbime të përkthimit me titull “Përkthimi i librave nga gjuha angleze në gjuhen shqipe për nevojat e UP”. Rektor i Universitetit të Prishtinës ishte i akuzuari Enver Hasani kurse shef i Prokurimit ne UP ishte i akuzuari Hakif Veliu në kohën kur është bërë kjo ftesë.

Sipas dosjes se tenderit me numër te lartcekur për ketë tender UP ka zotuar mjete financiare në vlerë prej 500.000€, ndërsa kusht për fitimin e tenderit ishte oferta(tenderi) ekonomikisht me i favorshëm, çmimet ne kontratë ishin te fiksuara dhe nuk mund të ndryshoheshin. Kurse, çmimi i përkthimit ishte përcaktuar sipas njësisë matëse “fjalë” dhe sasia “1000”. Pas shpalljes se tenderit UP me 24.07.2008 e cakton komisionin për vlerësimin e ofertave. Ky komision nga shtatë operator ekonomik sa kishin konkurruar kishte konsideruar si ofertues me të përgjegjshëm operatorin ekonomik - Institutin e Studimeve Ndërkombëtare(ISN) ne Tiranë i cili ne bazë të ofertës se datës 10.07.2008 (të nënshkruar nga Albert Rakipi - Drejtori i këtij Instituti) del se kishte ofertuar me çmimin prej 12.65€ për 1000 fjalë.

Rezulton se me 5.12.2008 Universiteti i Prishtinës(UP) si autoritet kontraktues kishte lidh kontratën me operatorin ekonomik -ISN ne Tiranë me numër reference 43/08 të cilën kontratë e kishte nënshkruar Albert Rakipi ne cilësinë e Drejtorit të Institutit dhe Hakif Veliu ne cilësinë e Drejtorit të Prokurimit ne UP. Sipas nenit 17 te kësaj kontrate çmimi i përkthimit ishte njësia matëse fjalë (1000 fjalë 12.65€) kurse vlera e përlogaritur e totalit të kontratës ishte 500.000€.

Pas lidhjes se kontratës del se ISN kishte kryer shërbime – përkthyer tetë libra dhe kishte faturuar një faturë me datë 13.07.2009 ne formë tabelore me titull përkthimi librash anglisht shqip nr.43/08. 05/12/08 për tetë libra ne të cilës njësia matëse ishte shkruar 1000/f kurse çmimi 12.65 në shumë totale prej 78.999.25€. Kjo faturë ishte nënshkruar nga tani i akuzuari Albert Rakipi. Me të njëjtën datë Albert Rakipi si drejtor i ISN kishte faturuar një faturë me titull përkthim raportesh shqip anglisht, nr.43/08. 05/12/08 ne të cilën njësia matëse ishte 1000/f kurse çmimi 12.65 në shumë totale prej 8.542.55€ të cilën po ashtu e kishte nënshkruar. Rezulton se Marijan Dema si Prorektor i Financave te UP ne atë kohë me vendimin pa datë dhe numër kishte formuar komisionin për pranimin e shërbimeve te përkthimit ne përbërje prej anëtareve Shpresa Hoxha, Lindita Tahiri dhe Afrim Hoti te cilët i sipas këtij vendimi kishin për detyrë që të kontrollojnë te gjitha shërbimet e realizuara nga ISN dhe ne harmoni të plotë me kërkesat e Autoritetit kontraktues si në sasi dhe në cilësi sipas specifikimit teknik të përshkruar ne kontratë dhe po ashtu duhej të përpilonin raport lidhur me cilësinë e shërbimeve të kryera në përputhje me kërkesat e Autoritetit kontraktues. Sipas raportit të këtij komisioni datë 20.07.2009 del se ISN i kishte kryer te gjitha shërbimet në cilësi dhe sasi në harmoni të plotë me kërkesat e Autoritetit kontraktues, dhe i kishin rekomanduar shërbimit financiar që të ekzekutoj të gjitha pagesat për 8 tituj e pranuar dhe raportet e akreditimit, të cilin raport anëtarët e komisionit edhe e kishin nënshkruar. Pastaj shefi i Prokurimit i akuzuari Hakif Veliu me 10.09.2009 ka lëshuar urdhër për pagesë (të cilën e ka aprovuar Fatbardha Grabanica) për pagesën e shumës prej 87.541.80€. Kurse me 17.09.2009 është lëshuar urdhër transferi ndërkombëtar për ISN për pagesën e shumës prej 87.541.80€.

Pas realizimit të kësaj pagesë del se tani i akuzuari Albert Rakipi kishte faturuar edhe një faturë me 2.12.2009 për shërbimet e kryera përkthimin e 11 librave sipas njësisë matëse 1000/F për çmimin 12.65 në shumë totale prej 299.488.75€. Në kohen kur është faturuar kjo faturë Rektor i Universitetit ishte Mujë Rugova. Universiteti i Prishtinës kishte refuzuar pagesën e kësaj fature kurse Këshilli Drejtues i Universitetit me vendimin e datës 26.10.2010 kishte formuar komisionin ne përbërje prej 5 anëtareve (ne mesin e tyre ishte edhe Marjan Dema) për shqyrtimin e rastit të përkthimit të librave dhe pagesave për këto përkthime, i cili komision kishte përpiluar raport me shkrim (datë 28 janar 2010) të cilin ia kishte dorëzuar Këshillit Drejtues të Fakultetit, e sipas të cilit raport UP si autoritet kontraktues bazuar ne kontratën e lidhur dhe pagesën e kryer për tetë tituj librash në shumë prej 78.999.25€ kishte paguar me tepër 48.000€ sesa vlera e punës ne bazë të kontratës. Me këtë vlerësim të komisionit ishte njoftuar ISN dhe përfaqësuesi i saj (Jorgji Qiriajko) e kishte refuzuar bashkëpunimin e mëtejme duke ua dërguar përmes emali-it kontratën në të cilin ishte përcaktuar se pagesa për përkthime duhet te behet sipas njësisë matëse “karaktere” dhe e cila kontratë ishte nënshkruar nga Albert Rakipi dhe Hakif Veliu dhe që kishte numër dhe datë të njëjtë me kontratën origjinale ne të cilën ishte përcaktuar çmimi sipas njësisë matëse “fjala”. Bazuar ne këtë raport Rektori i atëhershëm Mujë Rugova kishte kërkuar nga Drejtoria për krime ekonomike dhe korrupsion hetim te rastit.

Fillimisht hetimet kishin filluar vetëm ndaj shefit te prokurimit Hakif Veliu dhe Albert Rakipit -Drejtorit te ISN. Hakif Veliu i pyetur lidhur me kontratën ne të cilën ishte përcaktuar çmimi sipas njësisë matëse “karakterë” ka deklaruar se kontratë valide ishte kontrata ku në pikën 17 thuhej “1000 fjalë 12.65€” ngase kështu kishte qenë edhe ne specifikat teknike, po ashtu pagesa ishte bërë përmes thesarit dhe e njëjta kontratë gjendej ne thesar -Ministrinë e Financave, ndërsa kontrata e dytë nuk ishte valide dhe ishte falsifikuar nga “ISN”- ne fakt ishte falsifikuar nënshkrimi i tij, po ashtu ne vend të menaxherit ishte nënshkruar Drejtori i ISN dhe ne pikën 17 ne vend “1000fjalë 12.65€” është shkruar “1000 karaktere 12.65€” dhe këtë kontratë nuk e posedonte UP. Drejtori i ISN – Albert Rakipi është marrë në pyetje ne hetime nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka deklaruar se kontratën e parë me 5.12.2008 e ka nënshkruar Hakif Veliu dhe Jorgji Qirijako – zëvendës drejtor i ISN i autorizuar nga ai për nënshkrimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës ai kishte kundërshtuar disa nene te kontratës nenit 17 sipas te cilit njësia matëse ishte përcaktuar “fjala” dhe jo “karakterë” si dhe neni 7 e 9 i kontratës. Me 8.12.2008 zëvendës drejtori i kishte dërguar email Rektorit -Enver Hasanit ku e kishte njoftuar se njësia matëse “fjala” nuk mund të përdorej dhe e kishte pyetur nëse Hakifi mund tua dërgonte një kopje të kontratës për ndryshim. Sipas deklaratës së tij ndryshimi i kontratës së parë ishte bere me pajtimin e plotë të UP dhe kishte ofruar si prova – korrespondencën me email në mes të zëvendës drejtorit Jorgji Qirijako dhe rektorit – Enver Hasani dhe Hakif Velikut – shefit te prokurimit. Pasi që janë bërë ndryshimet e kontratës me 13.12.2008 kontratën e ndryshuar e kishte sjellë Enver Hasani se bashku me Marjan Demen te cilën e kishte nënshkruar Albert Rakipi. Pas deklaratës së Albert Rakipit Prokurorja i zgjeron hetimet edhe ndaj Enver duke i ngarkuar që të tretë si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale të mashtrimit në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK. Meqë i akuzuari Hakif Veliu kishte mohuar faktin se ne kontratën e ndryshuar ishte nënshkrimi i tij Prokurorja ka urdhëruar që të behet ekspertiza grafologjike, dhe sipas ekspertizës grafologjike te kryer nga Agjencioni Kosovar i Forenzikës-Sektorit për ekspertimin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve datë 8.07.2015 ka rezultuar se kontratën me nr.ref.43/08 datë 5.12.2008 ne të cilën ne nenin 17 ishte shënuar njësia matëse për pagese “karakterë” nënshkrimi ishte i tani të akuzuarit Hakif. Po ashtu ishte urdhëruar edhe ekspertiza financiare te cilën ekspertizë e kishte kryer ekspertja Ferdese Tërshnjaku sipas të cilës çmimi për përkthimin e tetë librave sipas njësisë matëse “fjala” ishte 14.987.52€, kurse çmimi për përkthimin e dokumenteve te akredimit sipas kësaj njësie ishte 1.403.11€, kurse çmimi i përkthimin për 11 librave sipas njësisë matëse “fjalë” ishte 33.450.36€. Në cilësinë e dëshmitarit ne hetime është dëgjuar Marian Dema i cili ne kohen e lidhjes se kontratës sipas tenderit te shpallur nga UP ishte Prorektor i financave, ndërsa ne kohen kur është bërë pagesa e faturave ishte ushtrues detyre i Rektorit, e që në dëshminë e tij ka deklaruar “*se nuk dinte asgjë për ekzistimin e dy kontratave për përkthimin e librave. Në cilësinë e prorektorit kishte formuar një komision i cili kishte pasur për detyrë që ta bëjë pranimin e materialeve të përkthyer nga ISN dhe ti raportoj shefit të prokurimit Hakif Velikut. Kishte shkuar disa herë se bashku me Enver Hasanin ne Tiranë ku janë takuar edhe me Albert Rakipin e që njëherë me të kishin darkuar por nuk është bisedua për kontratë*”. Janë dëgjuar edhe Shpresa Hoxha, Lindita Aliu dhe Afrim Hoti - anëtarët e komisionit për pranimin e materialit të përkthyer por sipas dëshmisë se tyre ky komision kishte për detyrë për të vlerësuar cilësinë dhe sasinë e materialit te përkthyer nga ISN por nuk kishte te bënte me çështje të pagesave dhe se asnjëherë nuk e kishin parë kontratën e lidhur mes UP dhe ISN-ës, kurse raportin rreth vlerësimit të materialit e kishte përgatitur Hakifi dhe

ata e kishin nënshkruar. Po ashtu janë dëgjuar edhe dëshmitaret Bajram Berisha – prorektor për mësimdhënie dhe kërkime shkencore dhe Esat Kelmendi- sekretar i UP.

Prokurorja me rastin e ngritjes se akuzës nuk propozon që të administrohet si provë korrespondenca elektronike mes Jorxhi Qiriajako, Enver Hasanit dhe Hakif Veliut. Gjatë shqyrtimit gjyqësor meqë të akuzuarit nuk e pranojnë fajësinë gjykata vazhdon me administrim të provova të propozuar me akuzë dhe pas dëgjimit të dëshmitareve të lartcekur me pëlqimin e palëve respektivisht edhe të Prokurës lexohet deklarata e dëshmitarit Marjan Dema e dhënë ne hetime. Në shqyrtimin gjyqësor dëgjohej edhe ekspertja Ferdese Tershnjaku përkitazi me ekspertizën financiare të kryer nga ana e saj dhe pas dëgjimit të saj gjykata me kërkesën e mbrojtësve të të akuzuarve urdhëron që të kryhet ekspertize tjetër ne përbërje prej tre ekspertëve të cilën ekspertizë ia beson Fakultetit Ekonomik. Ne këtë ekspertizë respektivisht pikës 4 të ekspertizës ekspertët kanë bërë vlerësimin financiar të përkthimeve duke u bazuar në njësinë matëse “fjala” dhe “karakteret” dhe kanë konstatuar

Vlera e përkthimeve sipas njësisë matëse “fjalë” për 8 libra dhe raportet e akreditimit është 16.333.86

Vlera e përkthimeve sipas njësisë matëse “fjalë” për 11 libra është 54.631.26€

Vlera e përkthimeve të tërësishme sipas njësisë matëse fjalë është 70.965.12€, kurse

Vlera e përkthimeve sipas njësisë matëse “karakteret” për 8 libra dhe raportet e akreditimit është 86.465.13€

Vlera e përkthimit sipas njësisë matëse “karakteret” për 11 libra është 293.247.51€

Vlera e përkthimeve të tërësishme sipas njësisë matëse “karakteret” është 379.712.63€(shih tabelën nr. 4 te ekspertizës)

Sipas eksperteve faturimi nga ana e kryesit të shërbimeve (ISN) është kryer duke u bazuar në njësinë matëse “karakteret”. Ndërsa bazuar në njësinë matëse “fjala” për vëllimin(sasinë) e përkthimeve të realizuara vlera e faturimit do të ishte:

1. Për tetë (tetë) libra universitare të përkthyer vlera e faturës nr.1 e datës 13.07.2009 do të ishte 14.991.91€

2. Për materialin e akreditimit të përkthyer vlera e faturës nr.2 e datës 13.07.2009 do të ishte 1.341.95€

3. Për njëmbëdhjetë(11) libra universitare të përkthyer vlera e faturës nr.2 e datës 2.12.2009 do të ishte 54.631.26€.Bazuar ne dokumentacionin qe kanë pasur kanë vlerësuar se sipas njësisë matëse “fjalë” kemi një ndryshim financiar ne shumë prej 16.576.53€ që është rezultat i mosharmonizimit të njësisë matëse “fjalë” dhe “karakteret”.

Në shqyrtimin gjyqësor janë dëgjuar dy prej eksperteve që e kanë përpiluar ekspertizën të cilët e kanë mbështetur ekspertizën e bërë me shkrim. Kurse, Prof.ass.Dr. Muhamet Aliu ka sqaruar se ndryshimi prej 16.576.53€ rrjedh bazuar ne

vlerën e faturimit me TVSH që sipas njësisë matëse “fjala” është 70.965.42€, kurse vlera e paguar është 87.541€ me TVSH, ndërsa sa i përket faturës së dytë e njëjta nuk është paguar por nuk është marrë për bazë për të vlerësuar ndryshimet financiare sipas faturës së parë. Pas dëgjimit të eksperteve prokurorja ka propozuar që të dëgjohet ne cilësi të dëshmitarit Jorgji Qirjako, kurse mbrojtësi i të akuzuarit Albert Rakipi përpos qe e a mbështet propozimin për dëgjimin e këtij dëshmitari të cilin e kishte propozuar edhe me herët propozon që të administrohen si prova korrespondenca elektronike ne mes te përgjegjësve të ISN dhe UP të cilat propozime gjykata i refuzon si të pabazuara.

Kurse, i akuzuari Albert Rakipi ne mbrojtjen e tij te dhënë ne shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera thekson” *arsyeja themelore që ne kemi kërkuar që të ndryshohen disa nga nenet e kontratës së përgatitur pa asnjë konsultim paraprak me UP kishte të bënte se kontrata ishte krejt e pazbatueshme dhe vendimi ishte nëse UP nuk do të pranonte ndryshimet nuk do të fillonin zbatimin e kontratës, e kjo nuk ishte as teorikisht e mundur të zbatohet një kontratë në mënyrën se si ishte formuluar njësia matëse “fjalë”. Kontrata e ndryshuar ne nenin 17 është dërguar ne Tiranë nga përfaqësuesi i autoritetit kontaktues te UP ne zarf dhe negocimi rreth ndryshimit të kësaj kontrate ishte mbyllur me 11.12.2008 kur nen drejtori Jorgji Qirijako e kishte pyetur Hakifin nëse duhej të shkonte në Prishtinë për ta nënshkruar, por Hakifi i kishte thenë se nuk kishte nevojë sepse te njëjtën do t’ia përcillte ne Tiranë përmes shoferit te UP ngase rektori udhëtonte për Tiranë. Me 13.12.2008 Jorxhi e kishte njoftuar se e kishte marrë kontratën e re dhe pasi e kishte nënshkruar dy kopje te kontratës i kishte futur ne zarf dhe ia kishte dhënë shoferit te cilat i kishte kthyer ne Prishtinë. Ka njohuri se kushtet për fitimin e nderit apo lidhjes se kontratës kanë qenë të përcaktuar sipas njësisë matëse “fjala”, por sa i përket ofertës se përgatitur nga ISN thekson se dosjen e ka plotësuar sekretarja. E pranon faktin se ne kontratën e ndryshuar është nënshkrimi i tij, kurse sa i përket kontratës origjinale thekson se nuk e ka nënshkruar por e ka autorizuar Jorgjin ta nënshkruaj. Nuk e pranon faktin se ne deklaramet e mëhershme kishte theksuar se kontratën e kishte sjell Rektori (Enver Hasani) duke theksuar se ai e kishte sjell një post(zarf) dhe kjo kontratë kishte arritur bashkë me nen rektorin Marjan Dema dhe mund ta sillte edhe dikush tjetër apo me post. Me tej ka theksuar se në asnjë rast gjatë bisedës dhe takimit me Enver Hasanin ku ka qenë edhe Marjan Dema e Qirijako nuk ishte diskutuar për kontratën apo elementet e saj”.*

Pas dhënies se mbrojtjes se këtij të akuzuari Prokurorja ka propozuar që të dëgjohet ne cilësi të dëshmitarit Jorgji Qirijako, të cilin propozim gjykata e aprovon. Ky dëshmitar ne dëshminë e tij nder të tjera deklaron “ sa i përket procesit të tenderimit ka marrë pjesë ne atë proces ngase ka qenë detyra kryesor e tij. ISN kishte ofertuar ne tender por çmimin e kishin konsideruar me “karakter “, por kishte dal qe UP ne template e kishte përcaktuar çmimin e përkthimit me “fjalë”. *Fakti se ISN kishte ofertuar sipas njësisë matës “fjalë” ishte lëshim teknik i sekretares. Me 5.12.2008 ai kishte ardhur ne Prishtinë dhe ishte takuar me Hakifin dhe pasi që ishte autorizuar nga Drejtori e kishte nënshkruar kontratën ne mirëbesim pa e lexuar. Pasi që ishte kthyer ne Tiranë kishte vërejtur tri probleme lidhur me kontratën çmimi me “fjalë” (e qe e dinte se ishte me karaktere) e qe bënte kontratën te pazbatueshme dhe neni 7 e 9 i kontratës. Me 8.12.2008 i kishte shkruar email Enver Hasanit sepse “ishte kreu i institucionit”, e pastaj Hakifi e kishte kontaktuar me email duke e pyetur për vërejtjet rreth kontratës. Ne përgjigjen e kthyer Veliu pasi që ishte shqyrtuar me bordin kishte*

renë dakord lidhur me ndryshimin e kontratës sa i përket nenit 17, por jo për nenet 7 e 9 të kontratës. Kjo marrëveshje kishte përfunduar me 10 e 11 dhjetor dhe pastaj ishte përpiluar kontrata e re të cilën në mënyrë elektronike ia kishte dërguar Hakifit, i cili i kishte thënë se nuk kishte nevojë të shkonte në Prishtinë për nënshkrim ngase do të vinin në Tiranë përfaqësuese të UP për të marrë pjesë në konferencën që e organizonte Emeli Haber. Me 13.12.2008 ishte takuar me dy përfaqësues të UP me Enver Hasanin dhe Marjan Dema këtë të fundit nuk e kishte njohur dhe meqë voziste kishte menduar se ishte shoferi, dhe i cili ia kishte dhënë zarfin e Hakifit pasi që Drejtori kishte nënshkruar, dy kopje të kontratës i kishin futur në zarf dhe ia kishte dhënë Marjanit për t'ia dhënë zarfin Hakifit. Sipas dëshmitarit Marjani nuk e dinte se çka kishte në zarf. Meqë UP nuk i kishte kryer obligimet për kontingjentin e dytë të përkthimeve kishin bërë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. *Sa i përket korrespondencave elektronike me Enver Hasanin dhe Hakif Veliun nuk e di a ka qenë i informuar Alberti, e as a ka qenë i informuar me negociatat lidhur me kontratën e dytë që i kishte zhvilluar me Hakifin. Pasi që mbrojtësi i të akuzuarit Enver ia prezantoi shkresën e datës 26.11.2008 të firmosur nga rektori i Universitetit të Tiranës- Dhori Kule sipas së cilës takimi i rektorëve të Universiteteve shqipfolëse është mbajtur me 12/13/14 dhjetor 2008 e në të cilin kishte prezantuar i akuzuari Enver dëshmitari ka deklaruar se” atë që unë di me siguri se me 13.12.2008 jemi takuar në mëngjes unë Marjani dhe Enveri dhe jemi takuar përsëri në darkë dhe kemi biseduar për projektin e librave”.*

Pas dëgjimit të këtij dëshmitari Prokurorja ka propozuar që të administrohen si prova korrespondenca elektronike mes dëshmitarit dhe Hakif Veliut dhe të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit Marjan Dema dhe trupi gjykues e ka refuzuar një propozim të tillë. Sipas shkresave të lëndës del se pas dëgjimit të këtij dëshmitari Marjan Dema i bën kërkesë me shkrim gjykatës për tu dëgjuar në cilësi të dëshmitarit me të cilën kërkesë e kishte njoftuar edhe Prokuroren, të cilën kërkesë gjykata edhe e aprovon ndërsa me vendim të veçantë e refuzon kërkesën e Prokurores për tu administruar si provë korrespondenca elektronike në mes Jorgji Qirijakos dhe Hakif Veliut.

Dëshmitari Marjan Dema në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera deklaroi :

“ Në vitin 2008 ishte Prorektor i Financave i UP dhe në kuadër të funksionit të tij nuk kishte kompetencë lidhjen e kontratave në mes UP dhe subjekteve tjera. *Kontrata e lidhur në mes ISN dhe UP ka qenë e iniciuar, mbikëqyrur dhe përcjellur strikt nga Enver Hasani andaj nuk kam lidhje me kontratën sepse kontratat i bën zyra e Prokurimit. Ka njohuri se në vitin 2007 fillimisht është marrë një vendim nga Këshilli drejtues për plagjiatura pastaj ka filluar dënimi i profesorëve derisa është sensibilizuar opinioni i brendshëm dhe i jashtëm. Pastaj këshilli drejtues në një mbledhje ka ndarë 500.000€ për përkthim të librave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Lidhur me përkthimin e librave është shpall tenderi 2 herë i cili kishte dështuar herën e tretë me insistimin e Enver Hasanit i cili në atë kohë ishte Rektor me komisionin e APP(Agjencionin e Prokurimit) ishin takuar në restorantin “Pisha” dhe pas këtij takimi ky organ ka bërë revokimin e një neni që ti jepet tenderi operatorit në fjalë që të shkohet me ofertuesin burimor. Në atë takim ka qenë se bashku me Enverin, Hakifin dhe 2-3 persona zyrtar të prokurimit. Nuk i kujtohet koha kur është realizuar ky takim dhe as biseda që është zhvilluar, por sipas tij natyrisht është biseduar që të shkohet me një operator ekonomik. Ka njohuri se kontrata mes UP dhe*

ISN është lidhur me 5.12.2008, ndërsa sa i përket kësaj kontrate detyrë e tij ka qenë nisja e procedurave, caktimi i komisionit për vlerësim dhe pranim të punëve. Sa i përket detyrave të komisionit për pranim fillimisht përgjigjet se ka pas për detyrë që në përputhje me kontratën dhe prokurimin ti kontrolloj shërbimin për të cilën është dashur të behet pagesa pastaj ka deklaruar mendoj nuk jam i sigurt sa i përket komisionit por mendojë se nuk ka qenë detyrë e tyre të merren me çmimet e shërbimit. Para nënshkrimit të kontratës nuk ishte takuar asnjëherë me përfaqësuesit e ISN. Pas nënshkrimit me 12.10.2008 me kërkesën e Enverit kishin shkaur ne Tiranë dhe aty për herë të parë ishte takuar me Albert Rakipin dhe Jorgje Qirijako të cilët i kishin pritur ne mënyrë fenomenale dhe aty kishte mësuar se Enveri njihej me ta. Gjatë darkës nuk është biseduar për kontratën. Ne Tiranë kishte shkuar vetëm ai dhe Enveri dhe makinën e kishte vozit ai por nuk ka pas asnjë zarf me veti. Për ndryshimin e kontratës nuk e ka ditur askush dhe as bordi i Universitetit, ndërsa vet ka kuptuar ne vjeshtën e me vonshme të atij viti kur Enveri e kishte ftuar atë dhe Hakifin ne kafe ne "Germi". Ne këtë takim kishte kuptuar për ekzistencën e kësaj kontrate të cilën asnjëherë nuk e ka parë, kurse kur kishte shkuar Enveri ne tualet i kishte thënë Hakifit "se nuk ke berë mirë qe e ke bërë këtë veprim", sepse Hakifi nuk i ka njohur ata të ISN. Nuk i kujtohen detajet e bisedës se si është zhvilluar por aty e kishte mësuar këtë fakt për herë të parë. Ky takim ishte realizuar ne vjeshtën e vitit 2009. Ne pyetjen e parashtruar se meqë tani jeni Rektor i Universitetit a ka mund të ndodhë atëherë që të vije deri te ndryshimi i një kontrate pa dijeninë e Enver Hasanit dhe a mund të ndodh tani kur ju jeni Rektor është përgjigjur se "po". Ndërsa, pasi që i është tërhequr vërejtja se ne hetime nuk keni deklaruar kështu dëshmitari është përgjigjur "sot kam ardhur me ndihmuar të drejtën, ne atë kohë kam mëndu ashtu por tani e di mirë se si ka punuar si loti. Nga kjo distancë kohore un vij ne përfundim se Enver Hasani ka mundur ti kryejë gjerat prapa shpinës sime dhe është e vërtetë se publikisht nuk mu ka përzier". Ndërsa ne pyetjen e parashtruar se në pikëpamje të klerkalisë zyrtari i prokurimit kujt i është përgjigjur ka deklaruar se prokurimi ka status special, ata i përgjigjen vetëm APP-OSHP, un ne komisione kam bashkëpunuar me ta vetëm ne komisione.

Bazuar në këtë gjendje të fakteve kontestuese sipas mbrojtëseve të të akuzuarve janë faktet:

1. Se gjykata e shkallës së parë pa bazë e ka refuzuar administrimin provës – korrespondencën elektronike ne mes të akuzuarit Hakif Veliut dhe Jorgji Qirijako (te cilin pretendim e thekson edhe Prokurorja ne ankesë)?
2. Se me provat e administruara nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer këtë vepër penale ashtu siç i ngarkon akuza dhe konkludon edhe gjykata e shkallës së parë?

Kjo Gjykatë pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura ka nxjerrë këto përfundime:

Nuk rezulton kontestues fakti se prova- korrespondenca elektronike ne mes të akuzuarit Hakif Veliu dhe dëshmitarit Jorgji Qirijako i është dorëzuar Prokurorisë së Kosovës nëpërmjet Prokurorisë së Tiranës dhe këtë provë nuk e kanë kundërshtuar të akuzuarit Hakif Veliu dhe Albert Rakipi. Mirëpo, është Gjykata ajo që vlerëson ligjshmërinë e provave dhe sa ato provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e

dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi. Meqë, ne rastin konkret kemi të bëjmë me një provë për nxjerrjen e së cilës është dashtë të lëshohet urdhëresë nga gjykata dhe origjina e marrjes së saj nuk dihet (dëshmitari Jorxhi Qirijako sa i përket *korrespondencave elektronike te tij me Enver Hasanin dhe Hakif Veliun ka deklaruar nuk e din a ka qenë i informuar Alberti*) kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar administrimin e kësaj prove. Ne fakt arsyet të cilat i ka dhënë shkalla e parë i mbështet edhe kjo Gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme te beje edhe njëherë vlerësime ne këtë drejtim.

Ndërsa, në kontekst të vlerësimit të gjithmbarshëm të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo Gjykatë i vlerësoj veprimet e të akuzuarve të përshkruara ne akuzë, por, qëndrimin e akuzës dhe gjykatës së shkallës së parë sa i përket te akuzuarit Enver Hasani ne raport me provat e administruara kjo Gjykatë nuk e vlerëson si të drejtë, për këto arsye:

Se, pari nuk është vërtetuar se i akuzuari Enver Hasani sipas marrëveshjes paraprake me të akuzuarit Hakif Veliu dhe Albert Rakipi me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore ne mënyrë të kundërligjshme për kompaninë ISN kanë falsifikuar – ndryshuar kontratën origjinale. Me asnjë provë nuk argumentohet fakti se ne ç’vend dhe ne ç’kohë u mor vesh paraprakisht i akuzuari Enver me dy të akuzuarit tjerë, si u mor vesh dhe ne ç’mënyrë. Ne këtë drejtim gjykata e shkallës së parë konkludon se meqë nënshkruarit e kontratës ishin akorduar ti bëjnë ndryshimet dhe kishin përpiluar një kontratë të re Enver Hasani ne cilësinë e Rektorit te Universiteti kishte qenë në dijeni për të ecurinë e ngjarjes, dhe këtë rrethanë e ka vërtetuar dëshmitari Marjan Dema. Pra, faktin se i akuzuari Enver Hasani ishte ne dijeni për ndryshimin e kontratës Gjykata e konsideron marrëveshje paraprake respektivisht bashkëkryerje apo veprim me të cilin i akuzuari ka kontribuar thelbësisht ne kryerjen e veprës penale, mirëpo, dëshminë e këtij dëshmitari kjo Gjykate e konsideron jo kredibile per arsyet te cilat do te jepen ne vijim.

Se, dyti ne dispozitivin e aktgjykimit theksohet se “Jorgji Qirijako -zëvendës drejtori i kompanisë ISN te akuzuarit Enver Hasani me 8.12.2008 i ka dërguar kërkesë për ndryshimin e kontratës nga njësia matëse “fjala” në njësinë matëse “karakteret” ku pastaj i akuzuari Hakif Veliu sipas marrëveshjes me të akuzuarin Enver Hasani ka përpiluar një kontratë të re ne të cilën ka ndryshuar nenin 17 te kontratës origjinale, e të cilën kontratë Enver Hasani me 13.12.2008 e ka dërguar ne Tiranë për ta nënshkruar Albert Rakipi. Por, as këto veprime nuk rezultojnë të argumentuara për këto arsye:

Në të vërtetë i akuzuari Albert Rakipi ne mbrojtjen e tij të dhënë ne hetime ka deklaruar se ndryshimi i kontratës së parë është bërë ne pajtim te plotë me Universitetin e Prishtinës për këtë ka ofruar si provë korrespondencën me email ne mes të zëvendës drejtorit Jorgji Qirijako, Enver Hasanit dhe Hakif Veliut, mirëpo ka theksuar se me 13.12.2008 kontrata e re u soll ne Tirane nga Drejtuesit e UP- rektori Enver Hasani dhe Prorektori Marjan Dema. Përkitazi me korrespondencat elektronike është bërë fjalë me lart, por vlen te theksohet se ne shqyrtimin gjyqësor ky i akuzuar nuk e ka mbështet një deklaram të tillë. Në fakt ky i akuzuar ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se kontrata e ndryshuar është sjell ne Tiranë nga autoritet kontraktuese ne zarf, kurse Jorgji Qirjako e kishte njoftuar se e kishte marrë kontratën e re dhe ia kishte sjellë të cilën pas nënshkrimit dy kopje te saj i kishte mbajtur Instituti kurse dy

kopje tjera i kishte futur ne zarf dhe ia kishte dhënë shoferit. Përveç kësaj ky i akuzuar ka deklaruar “arsyeja themelore që ne kemi kërkuar që të ndryshohen disa nga nenet e kontratës së përgatitur pa asnjë konsultim paraprak me UP kishte të bënte se kontrata ishte krejt e pazbatueshme dhe vendimi ishte nëse UP nuk do të pranonte ndryshimet nuk do të fillonin zbatimin e kontratës, e kjo nuk ishte as teorikisht e mundur të zbatohet një kontratë në mënyrën se si ishte formuluar njësia matëse “fjalë”. Kurse, dëshmitari Jorgji Qirjako ka theksuar se me 13.12.2008 ishte takuar me dy përfaqësues të UP me Enver Hasanin dhe Marjan Dema ketë të fundit nuk e kishte njohur dhe meqë voziste kishte menduar se ishte shoferi, dhe i cili ia kishte dhënë zarfin e Hakifit pasi që Drejtori kishte nënshkruar, dy kopje të kontratës i kishin futur ne zarf dhe ia kishte dhënë Marjanit për t’ia dhënë zarfin Hakifit, por Marjani nuk e dinte se çka kishte ne zarf. Ndërsa, dëshmitari Marjan Dema kategorikisht e ka mohuar faktin se me rastin e shkuarjes me Enver Hasanin ne Tirani ia ka dhënë zarfin Qirjakos. Pastaj, me asnjë prove nuk argumentohet se si Enver Hasani ne marrëveshje me Hakifin e përpiloi kontratën e re.

Se treti, dëshmia e dëshmitarit Marjan Dema sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është skajshmërisht e papranueshme. Kjo vetëm për faktin se dëshmia e tij e dhëne ne hetime është diametralisht e kundërt me atë të dhënë në shyrtimin gjyqësor, por edhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë prove për t’i argumentuar te thënat e tij. **Ne fakt ne hetime me asnjë fjalë nuk e inkriminon te akuzuarin Enver Hasani kurse ne shqyrtimin gjyqësor i paraqitur vullnetarisht ne emër të drejtësisë për të dëshmuar përkundër faktit se ne atë kohë ishte Prorektor i Financave deklaroi se “Kontrata e lidhur ne mes ISN dhe UP ka qene e iniciuar, mbikëqyrur dhe percjellur strikt nga Enver Hasani andaj nuk kam lidhje me kontratën sepse kontratat i bën zyra e Prokurimit”. Për ndryshimin e kontratës nuk e ka ditur askush dhe as bordi i Universitetit, ndërsa vet kishte kuptuar ne vjeshtën e me vonshme të atij viti kur Enveri e kishte ftuar atë dhe Hakifin ne kafe ne “Germi”. Ne ketë takim kishte kuptuar për ekzistencën e kësaj kontrate të cilën asnjëherë nuk e ka parë, kurse kur kishte shkuar Enveri ne tualet i kishte thënë Hakifit “se nuk ke bërë mirë qe e ke bërë ketë veprim”, sepse Hakifi nuk i ka njohur ata të ISN. Sot kam ardhur me ndihmuar të drejtën, ne atë kohë kam mëndu ashtu por tani e di mirë se si ka punuar si loti. Nga kjo distancë kohore un vij ne përfundim se Enver Hasani ka mundur ti kryejë gjerat prapa shpinës sime dhe është e vërtetë se publikisht nuk mu ka përzier”**

Nese, ky dëshmitar është paraqitur ne gjykate për të dëshmuar ne emër të drejtësisë atëherë parashtrohet pyetja pse asnjëherë me parë nuk i theksoj këto fakte, kur kihet parasysh fakti se ai pos ne hetime është dëgjuar edhe ne polici ne cilësi të dëshmitarit. Si është e mundur që një person i kalibrit të tij te marrë pjesë ne bisedime ku behet fjalë për një iniciim të kundërligjshëm të procedurës se prokurimit dhe të mos e ndaloj atë veprim aq me tepër kur ishte Prorektor i Financave, dhe pse nuk e lajmëroj rastin ne polici ne kohen kur kishte kuptuar se ishte ndryshuar kontrata.

Është notore që gjykatat gjykojnë edhe në mbështetje të bindjes së vet të formuar gjatë procedurës, por, jo pa pasur prova që argumentojnë një bindje të tillë. Ne rastin konkret kjo Gjykate vlerëson se vjen ne shprehje aplikimi i institucionit juridik “in dublo pro reo”, sepse mungojnë provat valide që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Prandaj, kjo Gjykatë duke pasur parasysh gjendjen e fakteve në këtë çështje, vlerësoj se nuk ka nevojë për të administruar prova të reja apo për t'i shqyrtuar edhe një herë provat ekzistuese, por, në praninë e fakteve të vërtetuara për zbatimin e drejtë të ligjit penal duhet marrë aktgjykim lirues përkitazi me këtë të akuzuar.

Ndërsa, kjo Gjykate e mbështet qëndrimin e akuzës dhe konkludimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të akuzuarit Albert Rakipi dhe Hakif Veliu kurse pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve i konsideron si të pabazuara.

Duke pasur parasysh provat e administruara por edhe mbrojtjet e të akuzuarve te cilat ne mënyrë të detajuar janë theksuar ne këtë aktgjykim sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rezulton me pa mëdyshje se pas ftesës për tender (kontratë) te UP (si autoritet kontraktues) me nr.90400/08/043/211 datë 8.07.2008 për shërbime te përkthimit me titull “Përkthimi i librave nga gjuha angleze në gjuhen shqipe për nevojat e UP”, dhe shpalljes se tenderit si ofertues me i përgjegjshëm ishte zgjedhur operatori ekonomik – Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) ne Tiranë. Bazuar ne tenderin e shpallur Hakif Veliu ne cilësi te shefit te Prokurimi,t kurse Albert Rakipi ne cilësi te Drejtorit ISN me 5.12.2008 kishin lidhur kontratën me nr.ref 43/08 ku ne nenin 17 është përcaktuar çmimi i përkthimit sipas njësisë matëse “Fjalë” (1000 Fjalë 12.65€) ashtu siç ishte përcaktuar me tender dhe kishte ofertuar operatori ekonomik. Kurse, pas lidhjes se kësaj kontrate të akuzuarit e ndryshojnë kontratën e parë (përpilojnë një kontratë tjetër me numër dhe datë të njëjtë) respektivisht nenin 17 ashtu që ne këtë nen shënohet çmimi i përkthimit sipas njësisë matëse “karakterë” (1000 karaktere 12.65€) te cilën kontratë edhe e nënshkruajnë. Bazuar ne këtë kontratë i akuzuari Albert Rakipi për shërbimet e përkthyer (tetë libra dhe raportet e akreditimit) ka paraqitur për pagesë dy fatura te datës 13.07.2009 ne shumë prej 78.999.25€ dhe 8.542.55€ ne total 87.541.80€, dhe përkundër faktit se faturimi është kryer duke u bazuar ne njësinë matëse “karakterë” qe sipas super ekspertizës ndryshon nga vlera e faturimit sipas njësisë matëse “fjala”(sipas kësaj njësie vlera e këtyre përkthimeve ishte 16.333.86€ ndërsa janë paguar 87.541.80€) ne këto fatura ne rubrikën njësia matëse ka paraqitur “1000F”, kurse ne rubrikën çmimi 12.65€ të cilat edhe i ka nënshkruar dhe ne bazë te këtyre faturave vjen edhe deri te realizimi i pagesave.

Me këto veprime të akuzuarit sipas vlerësimit të kësaj Gjykate i kanë konsumuar të gjitha elemente objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor. Pra, duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura dhe arsyet e dhëna me gjerësisht ne aktgjykimin e kundërshtuar kjo Gjykate vlerëson se përkitazi me këta te akuzuar gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe ne mënyrë të plotë dhe se drejte janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal.

Vlen te theksohet se disa nga pretendimet e mbrojtësve ne ankesa janë theksuar edhe gjate shqyrtimit gjyqësor (si pretendimi i mbrojtësit t akuzuarit Albert Rakipi sa ky i akuzuar nuk e kishte statusin e personit zyrtar) dhe përkitazi me to gjykata e shkalles se pare ka dhënë arsye të cilat arsye i aprovon edhe kjo Gjykate dhe nuk e sheh te nevojshme te beje edhe njëherë vlerësime.

ç). Pretendimet ankimore sa i përket vendimit për dënim dhe kërkesës pasurore juridike

Prokurorja në ankesë sa i përket kësaj baze ankimore thekson se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit Hakif Veliu dhe Abert Rakipi ju ka shqiptuar dënime me burgim ne kohëzgjatje prej nga 6 muajve dhe konform dispozitës së nenit 47 të KPK këto dënime ua ka zëvendësuar me gjobë në shumë prej nga 10.000€, po këto dënime nuk janë në proporcion me rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, motivin e kryerjes së veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj dhe sjelljen e të akuzuarve pas kryerjes së saj. Për me tepër sipas Prokurës gjykata te akuzuarve ju ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjore dhe nuk ka dhënë asnjë arsye edhe pse konform dispozitave ligjore respektivisht nenit 75 te KPK është dashur të bëjë një gjë të tillë, kurse rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar nuk janë të asaj natyre që e arsyetojnë shqiptimin e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor. Mbrojtësi i të akuzuarit Hakif Veliu edhe pse e kundërshton aktgjykimin sa i përket kësaj baze ankimore në këtë drejtim nuk je arsye, kurse mbrojtësi i të akuzuarit Albert Rakipi meqë pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të ligjit penal konsideron se vendimi mbi dënimin është i ashpër.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e Prokurores janë te bazuara.

Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë së dënimit konform dispozitës së nenit 73 të KPK i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe si rrethana lehtësuese për të akuzuarit ka vlerësuar faktin se nuk ka te dhëna se me parë kanë qenë të dënuar dhe rrethanat e tyre familjare, kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Vlerësimin e tillë të rrethanave lehtësuese e pranon edhe kjo Gjykatë, mirëpo, vlerëson se ato nuk janë të asaj natyre që justifikojnë, ose janë të mjaftuara që të behet zbutja e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj, sidomos kur kihet parasysh pesha e veprës penale, prandaj e aprovoj ankesën e Prokurës dhe të akuzuarve ju shqiptoj dënime me burgim si në dispozitiv të këtij me bindje se këto dënime janë adekuate me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve, dhe se me to do të mund të ndikohet në parandalimin e tyre nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK. Pavarësisht asaj që mbrojtësit e të akuzuarve nuk e arsyetojnë vendimin për dënim kjo Gjykatë për arsyet e lartcekura konsideron se nuk ka vend që të akuzuarve t’ju shqiptohet dënim me i butë.

Kjo Gjykatë i vlerësoj edhe pretendimet ankimore sa i përket kërkesës pasurore juridike dhe gjeti se ato janë të bazuara.

Kështu, ne rastin konkret element cilësues i veprës penale është dobia pasurore ne vlerë që tejkalon shumë prej 5000€, dhe pa mëdyshje është vërtetuar se vepra penale ne rastin konkret ka rezultuar me dobi pasurore që tejkalon këtë shumë. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se sipas super ekspertizës vlere e përkthimeve të tërësishme për CD 1 dhe CD 2 (19 libra dhe raportet e akreditimit) sipas njësisë matëse “fjala” është 70.965.12€, kurse UP ka paguar 87.541.80 € dhe sipas kësaj njësie kemi një ndryshim financiar prej 16.576.53€ kurse UP si palë e dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike kjo Gjykatë i aprovoj kërkesat e mbrojtësve ne

ketë drejtim kurse palën e dëmtuar (UP) e udhëzoj ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kondorm dispozitës së nenit 403 e të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PAKR.nr.27/2018, me 2 maj 2018

Procesmbajtësi,
Përparim Zeka

Kryetari i kolegjit,
1. Afrim shala

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Hava Haliti